



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Bordi

VENDIM

Nr. 81, Datë 06.04.2018

MBI

**MIRATIMIN E RREGULLAVE PËR SIGURIMIN E AKSESIT TË PALËVE TË
TRETA NË SISTEMIN E TRANSMETIMIT DHE TRANSPARENCËN NË
SEKTORIN E GAZIT NATYROR**

Në mbështetje të nenit 16 të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, nenit 42, pika 3 dhe nenit 48 të Ligjit nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”; nenit 26 të “Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE”, miratuar me Vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016 si dhe parashikimeve të vendimit nr. 2018/01/PHLG-EnC, datë 12.01.2018 të Grupit të Përhershëm të Nivelit të Lartë të Komunitetit të Energjisë, bordi i ERE në mbledhjen e tij të datës 06.04.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga drejtoria e licencimit dhe monitorimit të tregut dhe drejtoria juridike dhe e mbrojtjes së konsumatorit, mbi fillimin e procedurës për miratimin e “Rregullave për sigurimin e aksesit të palëve të treta në sistemin e transmetimit dhe transparencën në sektorin e gazit natyror”,

Konstatoi se,

- Bazuar në autoritetin që i është dhënë dhe në përputhje me përcaktimet e nenit 42 pika 3 të Ligjit nr. 102/2015, “Për Sektorin e Gazit Natyror”, ERE miraton rregullat për sigurimin e aksesit të palëve të treta në sistemin e transmetimit dhe transparencën në sektorin e gazit natyror.
- “Draft- Rregullat për sigurimin e aksesit të palëve të treta në sistemin e transmetimit dhe transparencën në sektorin e gazit natyror”, janë hartuar në përputhje me referencat në Rregulloren e Komisionit (KE) Nr. 715/2009 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit Evropës.
- Bordi i ERE me vendimin nr. 31, datë 09.02.2018, filloi procedurën për miratimin e “Rregullave për sigurimin e aksesit të palëve të treta në sistemin e transmetimit dhe transparencës në sektorin e gazit natyror.”
- Në vijim të kësaj vendimarrje ERE ka vijuar me publikimin me media të njoftimit nr. 55/5 Prot., datë 12.02.2018, për fillimin e procedurës për miratimin e draft- “Rregullave për sigurimin e aksesit të palëve të treta në sistemin e transmetimit dhe transparencës në sektorin e gazit natyror”, me qëllim marrjen e komenteve nga palët e interesit.

- Me shkresën nr. 192 Prot., datë 09.02.2018, ERE ka kërkuar komente dhe opinione nga Ministria e infrastrukturës dhe energjisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë , Autoriteti i Konkurrencës dhe Albgaz sh.a.
- ERE në datën 19.02.2018 ka dërguar gjithashtu në formë elektronike këtë draft pranë Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë, për të marrë komentet e tij.
- Në përfundim të afatit të marrjes së komenteve dhe opinioneve nga palët rezultoi se mbi këtë praktikë janë shprehur Autoriteti i Konkurrencës dhe Albgaz sh.a.
- Autoriteti i Konkurrencës me shkresën nr. 129/1 Prot., datë 21.03.2018, ka përcjellë në ERE komentin se “Drafti i rregullave për sigurimin e aksesit të palëve të treta në sistemin e transmetimit dhe transparencën në sektorin e gazit natyror, nuk bie në kundërshtim me Ligjin nr. 9121, datë 28.07.20103, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar.
- Albgaz sh.a me shkresën nr. 44 Prt., datë 21.03.2018, ka shprehur vlerësimin dhe dakortësinë e saj në lidhje me fillimin e procedurës për vendimin e sipërcituar në zbatim të Ligjit nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE,

Vendosi:

1. Të miratojë “Rregullat për sigurimin e aksesit të palëve të treta në sistemin e transmetimit dhe transparencën në sektorin e gazit natyror“
2. drejtorja e licencimit dhe monitorimit të tregut të njoftojë të interesuarit për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

https://ere.gov.al/doc/RREGULLORE_PER_SIGURIMIN_E_AKSESIT_TE_PALEVE_TE_TRETA_NE_SISTEMIN_E_TRANSMETIMIT_DHE_TRANSPARENÇEN_NE_SEKTORIN_E_GAZIT_NATYROR_5_04_2018.pdf